

Silabusi i lëndës: **KLIMATOLOGJI APLIKATIVE**

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore		
Titulli i lëndës:	KLIMATOLOGJI APLIKATIVE		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I/semestri I		
Numri i orëve në javë:	2 + 1		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	E premte: 15-16:30, Dep. Gjeografisë, salla 2		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Valbon Bytyqi		
Detajet kontaktuese:	valbon.bytyqi@uni-pr.edu , https://sites.google.com/a/uni-pr.edu/valbonbytyqi/		
Përshkrimi i lëndës	<p>Klimatologjia e aplikuar ka të bëjë me rolin e klimës në proceset dhe fenomenet natyrore dhe sociale. Ajo përfshin njohuritë lidhur me përdorimin e të dhënave klimatike për të zgjidhur një sërë problemesh mjedisore, sociale dhe ekonomike. Klimatologjia aplikative shpjegon rolin e klimës në dukuritë dhe proceset gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, bimore e shtazore, pastaj në fenomenet sociale, si: vendbanimet, infrastruktura, bujqësia, turizmi, ekonomia etj. Rol të rëndësishëm i kushtohet ndryshimeve klimatike si dhe pasojat të cilat potencialisht do të paraqiten.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi themelor i Klimatologjisë aplikative është që të shpjegojë rolin e klimës në proceset dhe fenomenet natyrore e sociale, në mënyrë të komuniteti të jetë më i përgatitur për rolin e klimës dhe ndryshimet e mundshme për të pasur një mjedis jetësor më të mirë.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të dijë për elementet më të rëndësishme klimatike duke analizuar rolin e tyre në fenomenet natyrore dhe sociale ✓ Të analizojë elementet klimatike të një regjioni/treve ✓ Të interpretojë proceset natyrore të ndikuara nga kushtet klimatike ✓ Të shpjegojë ndikimin e klimës në proceset sociale ✓ Me anë të punës seminarike, studenti argumenton fenomenet e analizuar në terren. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30

Ushtrime teorike/ laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	5/semestër		5
Ushtrime në teren	4/semestër		4
Kollokuiume, seminare	8/ semestër		8
Detyra të shtëpisë	6/ semestër		6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	25/semestër		25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5/semestër		5
Projektet, prezantimet, etj.	7/ semestër		7/ semestër
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim, debate. Për ilustrim dhe përforsim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhën fotografi, ilustrime të ndryshme. Daljet në terren në të cilat do të ushtrohet njohja e karakteristikave klimatike		
Metodat e vlerësimit:	30% vlerësimi i parë (java 8) 20% aktivitete në klasë, prezantim, seminar 50% provim final.		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. R. D. Thompson, A. Perry (ed.) 1997: Applied Climatology. Routledge. London. 2. Bonan, G. – Ecological Climatology, 2016. 3. R. Pllana – Klima e Kosovës, ASHAK, 2015 4. Pllana, R., Bytyqi, V. – Karakteristikat agroklimatike dhe agrometeorologjike në zonat e ujitjes së tokës në Kosovë, Ujitja në Kosovë – menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme, ASHAK, 2015 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rohli, R., Vega, A. – Climatology, 4th ed, Jones & Bartlett Learning, 2018 2. Cubasch, U., D. Kasang (2000): Antropogener Klimawandel. Klett-Perthes. Gotha. 128 pp 		

Plani i dizajnuar i mësimit - Ligjëratat:		
Data:	Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
20.9.2024	I	Klimatologjia aplikative, definicioni dhe zhvillimi
27.9.2024	II	Matja dhe vrojtimi i elementeve klimatike, përpunimi statistikor i të dhënave klimatike
4.10.2024	III	Modelet klimatike, paraqitja grafike dhe hartografimi i të dhënave klimatike
11.10.2024	IV	Klima, proceset hidrologjike, resurset ujore
18.10.2024	V	Klima, akullnajat dhe tokat
25.10.2024	VI	Klima, proceset gjeomorfike dhe format relievore
1.11.2024	VII	Klima dhe vegjetacioni
8.11.2024	VIII	Klima dhe bota shtazore
15.11.2024	IX	Njeriu (komforti, veshja dhe shëndeti) dhe klima
22.11.2024	X	Ndikimi i klimës në planifikimin urban dhe hapësinor
29.11.2024	XI	Ndikimi i klimës në industri, tregti, transport
6.12.2024	XII	Ndikimi i klimës në bujqësi, peshkim, pylltari
13.12.2024	XIII	Ndikimi i klimës në turizëm, rekreacion
20.12.2024	XIV	Klima urbane, ndotja e ajrit
27.12.2024	XV	Ndryshimet klimatike, historia dhe e ardhmja

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime është i obliguar si dhe respektimi i rregullave të mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.

Mësimdhënësi i lëndës:
Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi